

## Komuna e Mitrovicës/Kosovska Mitrovica

### **Darko (Jeremija) Ivaz**

(8.08.1964, serb nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica, ekonomist, dy fëmijë, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

### **Milovan (Prvoslav) Nikolić**

(22.03.1974, serb nga Leshaku/Lešak, komuna e Leposaviqit/Leposavić, pjesëtar i MPB-së së Republikës së Serbisë)

Darko ka punuar në ekspoziturën e *Beobankës* në Zvečan/Zvečan. Ishte pjesëtar i forcave rezerve të MPB-së. Milovani punonte në stacionin policor në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica nga muaji gusht të vitit 1997.

Në datën **6.05.1998**, pasmesnate, Darko dhe Milovani me dy kolegë patrullonin në lagjen *Tamnik* [**Mitrovicë/Kosovska Mitrovica**]. Afër stacionit të autobusëve mbi patrullë ka shtënë Artim Jashari, pjesëtar i UÇK-së, i veshur në rroba civile, me ç'rast Darko, Milovani dhe të tjerët, që gjendeshin në atë patrullë, u kundërpërgjigjën me zjarr. Milovani u vra në vend, kurse Darko ishte i plagosur rëndë. Ai, një muaj më vonë [**5.06.1998**] nga plagët e shkaktuara ndërroi jetë në AMU në Beograd. Në këtë rast vdekjen e gjeti edhe Artim Jashari, ushtar i UÇK-së [të shikohet regjistrimi në vijim]. Milovani u varros më 6.05.1998 në fshatin Vraçevë/Vračevo [Leposaviq/Leposavić], ndërsa Darko u varros në Mitrovicë/Kosovska Mitrovica.

**Burimet:** *Dnevnik od 5. do 11. maja*, Ilustrovana politika, FDH-32198; CKS, *Regjistri...*, FDH-30729; SV SRJ, *Junaci otadžbine*, 28, 48; KKMRFJ, *Personat...*, FDH-10832; FDH, *Haški tribunal, Sudenje*

*Slobodanu Miloševiću*, II, 869-870; M. Nikolić, *Junacima...*, 26-29; SMIP, *Teroristički...*, III, 932-933; KMDLNJ, *Buletini*, num.7, prill-qershor 1998, 132, FDH-23816; SHFĐUÇK, *Feniksët...2*, 75-77; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

### **Artim (Sejdi) Jashari**

(2.07.1974, shqiptar nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica, student, pjesëtar i UÇK-së)

Artimi si 15-vjeçar mori pjesë në demonstratat për autonominë e Kosovës. Në UÇK aderoi në vitin 1997. Ka rënë më **6.05.1998**, me rastin e sulmit ndaj patrullës së policisë serbe, në afërsi të stacionit të autobusëve, në lagjen *Tamnik* në **Mitrovicë/Kosovska Mitrovica** [të shikohet regjistrimi i mëparshëm]. E kanë varrosur më 9.05.1998 në fshatin Zhabar/Žabar.

**Burimet:** SHFĐUÇK, *Feniksët...2*, 75-77; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092; FDH, *Haški tribunal, Sudenje Slobodanu Miloševiću*, II, 869-870; KKMRFJ, *Personat...*, FDH-10832.

### **Ramadan (Rexhep) Hajra**

(7.12.1973, shqiptar nga Mitrovica/Kosovska Mitrovica, teknik i makinerisë)

Ramadani ishte i martuar me Sadeten. Ata jetonin me familjen e Ramadanit në Shipol/Šipolje te Mitrovica/Kosovska Mitrovica. Në datën **1.06.1998**, në mes të orës 10:00 dhe 11:00, Ramadan u nis për në qytet dhe nuk u kthye më kurrë. Familja e kërkoi, por pa sukses. Pas dy ditësh, i vëllai Burhani mësoi nga një burrë që e kishte shitoren afër stacionit të autobusëve në **Mitrovicë/Kosovska Mitrovica**, se e kishte parë se si